



Njoftim për Shtyp

AKADEMIA E KARRIERËS 2021 – “Një vizitë larg nga karriera juaj e ardhshme”

22-24 TETOR 2021, Bashkia Dibër

Prej 22-24 Tetor, 2021 u zhvillua në qytetin e Peshkopisë “Akademia e Karrierës” në kuadër të aktiviteteve të projektit “Një vizitë larg nga karriera juaj e ardhshme” i financuar nga Zyra e Marrdhënieve me Publikun të Ambasadës së SHBA-së në Tiranë dhe zbatuar nga AlbanianSkills.

Ky projekt zhvillohet në bashkëpunim të ngushtë me **Bashkitë Dibër, Mat dhe Kukës** dhe ka si qëllim krijimin e një serie shërbimesh për informim, orientim dhe zhvillim karriere për të rinjtë në përgjithësi dhe ato punëkërkuës në veçanti në këto bashki. .

Nga Bashkia Peshkopi morën pjesë rreth 35 të rinj të regjistruar online, punëkërkuës, studentë, gjimnazistë, mesues dhe të punësuar të cilët ndodheshin në një fazë kalimtare të jetës së tyre si përfundimi i shkollës së mesme, diplomimi në universitet ose në kërkim apo ndryshim të një pune. Akademia e Karrierës përfshiu tre module të trajnimit lidhur me *zhvillimin e aftësive dhe mundësive për punësim dhe vetë-punësim, sipërmarrjen, biznesin social dhe zhvillimin komunitar të shtjelluara* nëpërmjet temave vijuese : *Aftësitë për të njohur veten, Integriteti dhe etika në punë, Aftësitë Dixhitale, Aftësitë e Buta , Aftësitë për të kërkuar punë, Njohuritë mbi bazën ligjore, Sjellja Sipermarrese, Biznesi social, Zhvillimi i komunitetit dhe vullnetarizmi*, lojrave dhe ushtrimeve të ndryshme nga lektorë dhe profesionistë të fushave.

Gjatë të treja ditëve të akademisë ishin të ftuar si folës motivues përfaqësues të bizneseve, Zyrrave Rajonale të Punësimit dhe Shoqërisë Civile për t’i sjellë të rinjtë më afër tyre.

Dita e parë u hap me fjalën pëshëndetëse të Drejtoreshës Ekzekutive e Albanian Skills Znj. Ana Zacharian. Gjithashtu edhe pjestarët e stafit të bashkisë, Ardit Vraniçi, Përgjegjës i Strukturës së Integritetit dhe Valbona Kaloci dhe Përgjegjëse e Strukturës së Rinisë. Më pas u zhvillua një session me të





rinjtë për të njohur më mirë veten dhe për të zbuluar më shumë rreth qëllimeve dhe planeve për karrierën e tyre.

Dita e dytë nisi me një vizitë nga Drejtori i Shkollës ‘Said Najdeni’, Klodian Datja së bashku me disa mësues të tjerë të kësaj shkolle. Gjatë vizitës së tyre u zhvillua një bashkëbisedim interesant me të rinjtë e akademisë.

Akademia u moderua nga Kordinatorja e Projektit, Znj. Ana Zacharian, në mbështetjen e Koordinatorit Lokal Z. Denis Lushi.


Trupa e trainerëve dhe lehtësuesve të sesioneve ishin: Znj. Vera Istrefaj, Znj. Dorina Islami, Z. Edison Bib, Znj. Ana Zacharian, Z. Entela Gjyla.

Në përfundim të akademisë u zhvillua një sesion i zgjeruar vlerësi ku të gjithë pjesëmarrësit dhanë përshtypjet e tyre dhe përfitimet nga kjo Akademi e Karrierës. Disa nga njohuritë më të vlefshme për ta nga trajnimet ishin: shkrimi i një CV-je, sjellja në intervisten e punës, inteligjenca emocionale, aftësitë dixhitale, sipërmarrja sociale, aftësitë komunikuese, zhvillimi i vullnetarizmit etj.















albanianskills
We promote skills



U.S. EMBASSY
Tirana, Albania